

ANEKSI 2

RREGULLIMI I RIMBURSIMEVE NGA PALA ITALIANE PËR PALËN SHQIPTARE

A. Fusha e veprimit

1. Ky Aneks rregullon:

- a) masën dhe mënyrën e rimbursimeve që Pala italiane i detyrohet Palës shqiptare në zbatim të nenit 10 të Protokollit;
- b) masën dhe mënyrën e rimbursimit të çdo detyrimi të papritur që Pala italiane i detyrohet Palës shqiptare të përmendur në këtë Aneks.

B. Krijimi i fondit për rimbursimin e shpenzimeve

1. Pala shqiptare krijon pranë Thesarit të shtetit një llogari të veçantë jo fitimprurëse me emërtimin “Fondi për rimbursimin e shpenzimeve të kryera në zbatim të Protokollit italo-shqiptare në kuadër të forcimit e bashkëpunimit për çështjet e migracionit”. Brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të Protokollit, Pala shqiptare i komunikon Palës italiane nëpërmjet kanaleve diplomatike, të dhënat e plota të identifikimit të llogarisë së përmendur në këtë paragraf, si dhe mënyrat me të cilat evidentohen hyrjet dhe daljet në llogari në kuadrin e kontabilitetit publik të Republikës së Shqipërisë.

2. Llogaria e përmendur në paragrafin 1 të këtij seksioni ndahet në nënlllogari për secilën nga kategoritë e shpenzimeve të treguara në seksionet C dhe D të kësaj shtojce. Shpërndarja e disponueshmërisë së llogarisë speciale të thesarit ndërmjet nënllogarive të ndryshme përcaktohet dhe ndryshohet nga Pala shqiptare në përputhje me nevojat e momentit dhe i komunikohet Palës italiane nëpërmjet rrugëve diplomatike.

3. Çdo shpenzim më i ulët që lidhet me një ose më shumë nënllogari përdoret kryesisht për të kompensuar shpenzimet më të larta në nënllogaritë e tjera.

4. Brenda 90 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të Protokollit, Pala italiane krediton shumën [16.5 milionë] euro në llogarinë e posaçme të thesarit të treguar në paragrafin 1 të këtij seksioni, si një paradhënie *a forfeit* e rimbursimeve që duhen bërë në përputhje me nenin 10 të Protokollit për vitin e parë të zbatimit të Protokollit.

5. Pala italiane mund kryej derdhjen në euro dhe konvertohen në lek me kursin e këmbimit në ditën e derdhjes.

6. Llogaria e veçantë e thesarit sipas pikës 1 të këtij seksioni mund të përdoret vetëm për qëllimet e shprehura nga ky Aneks. Disponibilitetet e kësaj llogarie janë të pasekuestrueshme.

C. Shpenzimet e rimbursueshme sipas nenit 10 të Protokollit

1. Shpenzimet e rimbursueshme sipas nenit 10 të Protokollit llogariten sipas metodave të parashikuara në këtë seksion.

2. Pala italiane rimbursin Palën shqiptare për kostot e parashikuara në nenin 4, paragrafi 9 të Protokollit në masën e treguar më poshtë:

a) 100% të shpenzimeve të kryera për ofrimin e shërbimeve të kujdesit spitalor të ofruara realisht në përputhje me manualin zyrtar të kostove të kujdesit shëndetësor të parashikuar nga legjislacioni shqiptar në fuqi. Pala shqiptare dokumenton administrimin faktik të trajtimeve spitalore për të cilat kërkon rimbursimin;

b) 100% të kostos së parashikuar në kontratat përkatëse të blerjes së pajisjeve mjeksore dhe barnave, përfshirë, me kërkesë të Palës italiane, vaksinat, për të cilat Pala shqiptare dokumenton përdorimin efektiv për qëllimet e parashikuara nga Protokollit. Kontratat e blerjes i vihen në dispozicion Palës italiane sipas kërkesës së saj.

c) 100% të kostos së blerjes, të aprovuar më parë nga autoritetet italiane, të artikujve dhe shërbimeve të ndryshme nga ato të përcaktuara në gjermën a) dhe b) të këtij paragrafi, të cilat janë të nevojshme për zhvillimin e aktiviteteve të parashikuara në këtë Protokoll.

3. Në rastet e parashikuara në nenin 6, pika 6, të Protokollit, Pala italiane i rimbursin Palës shqiptare:

a) 100% të shpenzimeve të dokumentuara që rrjedhin nga përdorimi i personelit të forcave policore, nga blerja e karburantit për automjetet e shërbimit të përdorura dhe shpenzime të tjera që lidhen drejtpërdrejt me shoqërimin e migrantëve.

b) 100% të shpenzimeve për blerjen, të aprovuar paraprakisht nga Pala italiane, të automjeteve apo mjeteve të nevojshme për zhvillimin e aktiviteteve të parashikuara nga ky Protokoll.

4. Në rastet e parashikuara në nenin 8, pika 3, të Protokollit, Pala italiane i rimbursin Palës shqiptare 100% të shpenzimeve të dokumentuara të personelit të forcave të armatosura dhe policisë, për blerjen e karburantit për mjetet e shërbimit të përdorura dhe shpenzimet e tjera që lidhen drejtpërdrejt me përdorimin e mjeteve dhe njësive të Palës shqiptare.

5. Si një alternativë për rimbursimin e kostove efektive në përputhje me paragrafët 3 dhe 4, Pala italiane mund të zgjedhë rimbursimin e kostove të përcaktuara në përputhje me vendimin nr. 591, datë 7 shtator 2022, "Për miratimin e llojit të shërbimeve shtesë që ofron policia e shtetit dhe tarifave të pagesës për personat juridikë dhe fizikë, publikë apo privatë". Autoritetet kompetente të Palëve, me marrëveshje reciproke, mund të bien dakord për metoda të ndryshme të llogaritjes fikse të shpenzimeve të përmendura në paragrafët 3 dhe 4, duke marrë gjithashtu parasysh ndryshimet e sistemit ligjor italian dhe atij shqiptar.

6. Në rastet e parashikuara në nenin 12, pika 2, të Protokollit, Pala italiane i rimbursin Palës shqiptare 100% të shpenzimeve të kryera realisht nga kjo e fundit dhe që rrjedhin nga:

a) shpenzimet ligjore të dokumentuara;

b) shpenzime të dokumentuara që korrespondojnë me punësimin e personelit të punësuar nga organet apo entet shtetërore ose subjektet e Republikës së Shqipërisë, të punësuar për mbrojtjen e tij në gjykatë;

c) shpenzime të dokumentuara për pagesën e avokatëve të lirë të kontraktuar, me pëlqimin paraprak me shkrim të Palës italiane, nga Pala shqiptare, të kufizuara në mbrojtjen para gjykatave ndërkombëtare;

d) çdo shpenzim tjetër e përcaktuar si shpenzim gjyqësor në vendimin gjyqësor.

e) dëmshpërblimin e dëmeve në bazë të vendimit të gjykatës kombëtare apo ndërkombëtare.

7. Kur, në rastet e përmendura në paragrafin 6, shkronja c) të këtij seksioni, Pala italiane merr përsipër drejtpërdrejt barrën e shpenzimeve të mbrojtjes në gjykatë, nuk kërkohet rimbursim për asnjë shpenzim shtesë të kryer nga pala shqiptare për pagesën e avokatëve të lirë të kontraktuar nga ajo.

8. Pala që merr përsipër mbrojtjen në gjykatë për mosmarrëveshjet e shprehura në pikat 6 dhe 7 të këtij seksioni, siguron që veprimtaria procedurale të kryhet me kujdesin maksimal dhe zbaton të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar rrezikun e humbjes në gjykatë. Pala tjetër siguron bashkëpunimin maksimal për mbrojtjen më të mirë në gjykatë. Mbrojtësit mbajnë kontakte të vazhdueshme me të dyja palët dhe ndjekin udhëzimet e tyre për mbrojtjen më të mirë në gjykatë.

D. Të paparashikuara dhe shpenzime të tjera

1. Pala italiane gjithashtu i rimbursion Palës shqiptare:

a) shpenzimet e dokumentuara që rrjedhin nga zbatimi i punimeve të urbanizimit dhe ofrimi i shërbimeve publike të nevojshme për funksionimin e strukturave të përmendura në Aneksin 1 të Protokollit, vetëm nëse ato janë të mbështetura drejtpërdrejt nga Pala italiane ose nga subjekte të ngarkuara prej saj;

b) dëmshpërblimet që rrjedhin nga proceset gjyqësore në të cilat Republika e Shqipërisë ose një nga institucionet e saj bëhet padashje palë për shkak ose si pasojë e zbatimit të Protokollit;

c) shpenzimet që rrjedhin nga dëme të tjera të paparashikuara, që i rezultojnë Palës shqiptare nga zbatimi i Protokollit, që nuk rrjedhin nga sjellja e qëllimshme ose neglizhente e Palës shqiptare dhe në atë masë që Pala shqiptare nuk ka mundur të shmangë pasojat e dëmshme me përdorimin e kujdesit normal. Mangësitë e shërbimit që rezultojnë nga aftësitë e kufizuara objektive të Palëve nuk konsiderohen të qëllimshme ose faj.

d) çdo humbje në vlerë e pagesave të kryera nga Pala italiane në përputhje me seksionet B dhe E të kësaj Aneksi, që rezulton nga zhvlerësimi i kursit të këmbimit.

2. Me mënyrat e parashikuara në seksionin E, Pala italiane rimbursion shpenzimet e përmendura në pikën 1 të këtij seksioni.

E. Rifinancimi i fondit për rimbursimin e shpenzimeve

1. Brenda datës 15 mars dhe 15 shtator të secilit prej viteve të vlefshmërisë së Protokollit, Pala shqiptare i komunikon palës italiane nëpërmjet kanaleve diplomatike shumën e shpenzimeve të përmendura në seksionet C dhe D të kësaj shtojce, të kryera në gjashtëmujorin e mëparshëm.

2. Kërkesa për rimbursim shoqërohet me kopje të njësuar me origjinalin të faturave për shërbimet e kryera dhe dokumentacionin e kërkuar në seksionet C dhe D të këtij Aneksi, që vërtetojnë shërbimin ose shpenzimin e kryer. Pala italiane mund të kërkojë sqarime dhe shtesa në dokumentacion.

3. Brenda 45 ditëve nga komunikimi i përmendur në pikën 1 të këtij seksioni, Pala italiane do të paguajë, në mënyrën e parashikuar në seksionin B të këtij Aneksi, shumën e kërkuar dhe të justifikuar nga Pala shqiptare, edhe si paradhënie për shpenzimet që ajo do të kryejë në gjashtëmujorin në vijim. Pas kësaj derdhje, shuma e llogarisë speciale të thesarit nuk mund të jetë më e vogël se 16.5 milionë euro. Në rast mosmarrëveshjeje për një pjesë të shumës së kërkuar nga Pala shqiptare, Pala italiane do të vazhdojë të paguajë pjesën e pakundërshtuar brenda afatit të përcaktuar në këtë paragraf.

4. Pala italiane do të zbrësë nga pagesat e parashikuara në përputhje me këtë Aneks, shumat që korrespondojnë me dëmet e pësura prej saj dhe që i atribuohen Palës shqiptare në përputhje me nenin 12, paragrafi 1, të Protokollit.

F. Fondi i garancisë

1. Për të siguruar rimbursimin e shpenzimeve të parashikuara në këtë Aneks, që tejkalojnë pagesat e bëra nga Pala italiane, në zbatim të seksioneve B dhe E të këtij Aneksi, Pala italiane krijon një fond garancie në favor të Palës shqiptare.

2. Brenda 90 ditëve nga hyrja në fuqi e Protokollit, Pala italiane hap, në një bankë të nivelit të dytë që operon në Republikën e Shqipërisë, një llogari rrjedhëse bankare të dedikuar ekskluzivisht për depozitimin e burimeve që lidhen me fondin e garancisë. Pala italiane i jep Palës shqiptare konfirmimin e depozitës dhe çdo ndryshim në detajet e llogarisë rrjedhëse, nëpërmjet kanaleve diplomatike. Shumat e depozituara në llogarinë e garancisë nuk mund të tërhiqen nga Pala italiane pa pëlqimin me shkrim të Palës shqiptare.

3. Interesat e përllogaritura në llogarinë rrjedhëse rrisin disponueshmërinë e fondit të garancisë. Shpenzimet për mbajtjen e llogarisë do të sigurohen me të njëjtën disponueshmëri.

4. Në rast të dështimit të kryerjes së pagesave nga Pala italiane në bazë të këtij Aneksi, Pala shqiptare do t'i njoftojë Palës italiane, nëpërmjet rrugëve diplomatike, ftesën të përmbushë detyrimin, duke specifikuar shumën dhe arsyet përkatëse. Nëse këto shuma

janë objekt mosmarrëveshesh të mëparshme nga Pala italiane, Pala shqiptare jep sqarimet e nevojshme.

5. Nëse Palët nuk arrijnë një marrëveshje brenda 45 ditëve nga njoftimi i përmendur në pikën 4 të këtij seksioni, Pala shqiptare mund të tërheqë nga fondi i garancisë të përmendur në këtë nen.

6. Burimet e tërhequra nga fondi i garancisë mund të kreditohen ekskluzivisht në llogarinë e posaçme të thesarit të njoftuar më parë nga Pala shqiptare, në përputhje me seksionin B. Pas tërheqjes, Pala shqiptare i dërgon palës italiane, nëpërmjet rrugëve diplomatike faturen e pagesës së kryer, e cila përbën kuitancën e shumave të detyrueshme për të gjitha qëllimet e parashikuara nga Protokollit.

7. Pala italiane njofton bankën ku është depozituar fondi i garancisë për dispozitat e këtij seksioni, të cilat mbizotërojnë mbi çdo dispozitë të ndryshme të kontratës ose të kushteve të shërbimit, të përcaktuara, të cilat rregullojnë llogarinë bankare në të cilën është depozituar fondi i garancisë.

8. Nga data e përfundimit të Protokollit ose nga data e denoncimit të tij nga njëra prej Palëve, paragrafi 5 i këtij seksioni do të pushojë së zbatuari.

9. Në zbatim të nenit 12, paragrafi 1, të Protokollit, në rast të tërheqjes së shumave nga fondi i garancisë në kundërshtim me këtë seksion, prezumohet faj i rëndë i Palës së cilës i atribuohet shkelja, me kusht që të vërtetohet që është e qëllimshme.

G. Shlyerja përfundimtare e rimbursimeve

1. Duke filluar nga data e skadimit të Protokollit ose e denoncimit të saj, seksioni E pushon së zbatuari. Brenda 60 ditëve nga datat e përmendura në pjesën e parë, Pala shqiptare komunikon nëpërmjet kanaleve diplomatike deklaratën përfundimtare të shpenzimeve të rimbursueshme sipas këtij Aneksi. Deklaratës i bashkëlidhen faturat për shërbimet e kryera dhe dokumentacioni që vërteton shërbimet dhe shpenzimet e kryera në përputhje me seksionet C dhe D të kësaj shtojce, të kufizuara në shpenzime të raportuara më parë.

2. Nëse shuma e shpenzimeve të raportuara siç duhet nga Pala shqiptare në përputhje me këtë Shtojcë është më e madhe se shuma e pagesave të bëra nga Pala italiane në thesarin shqiptar dhe tërheqjet nga fondi i garancisë të bëra nga pala shqiptare në përputhje me seksionin F i kësaj shtojce, Pala italiane paguan rimbursimin e mbetur që i takon Palës shqiptare, brenda 60 ditëve nga komunikimi i përmendur në pikën 1 të këtij seksioni.

3. Nëse shuma e shpenzimeve të raportuara saktësisht nga Pala shqiptare në përputhje me këtë Shtojcë është më e vogël se shuma e pagesave të bëra nga Pala italiane në thesarin shqiptar dhe tërheqjet nga fondi i garancisë të bëra nga Pala shqiptare në përputhje me seksionin F, Pala shqiptare do të paguajë në një llogari bankare të caktuar nga Pala Italiane shumën e marrë më tepër se shpenzimet e raportuara, brenda 60 ditëve nga kërkesa e Palës italiane. Rimbursimi bëhet në euro. Për llogaritjen e shumës së detyrimit, përdoret kursi i këmbimit në ditën e kërkesës nga Pala italiane.

4. Mos dokumentimi i kërkesës për rimbursim brenda afateve dhe në mënyrën e parashikuar në këtë seksion, sjell heqjen dorë përfundimisht nga rimbursimi dhe detyrimin për kthimin e shumave të pallogaritura.

H. Dispozitat përfundimtare

1. Autoritetet kompetente të Palëve mund të miratojnë, me marrëveshje të ndërsjellë, një ose më shumë manuale operationale për zbatimin më të mirë të këtij seksioni.

2. Pavarësisht nga dispozitat e nenit 13 të Protokollit, ky Aneks mund të ndryshohet me marrëveshje me shkrim të Palëve.